



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 518/8 prot.

Datë 28/04/2023

V E N D I M

Nr. 317/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28/04/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Shërbime marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha janë të përcaktuara, me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-48360-11-02-2022, me objekt: “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me fond limit të lotit 3.232.130 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Mbetjen të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Air” SHPK dhe të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Metani Green” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu” Pallati 2,
Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë.

Operatori ekonomik "Egian Med" SHPK

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Bly. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.11.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Shërbime marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha janë të përcaktuara, me afat 24 Muaj*”, me Nr. REF-48360-11-02-2022, me objekt: “*Shërbim Dezinsektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh*”, me fond limit të lotit 3.232.130 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Më datën 30.01.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 16.02.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alpest” SHPK	0,00 lekë	skualifikuar
2. “AIR” SHPK	975.000,00 lekë	skualifikuar
3. “ALPEN PULITO” SHPK	1.679.084,40 lekë	kualifikuar
4. “Metani Green” SHPK	1.959.022,00 lekë	skualifikuar
5. “EGIAN MED” SHPK	2.192.104,00 lekë	kualifikuar
6. “LOERMA” SHPK	2.244.952,00 lekë	skualifikuar
7. “Pastrime Silvio” SHPK	3.199.882,00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 03.03.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar Njoftimi i Fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ku fitues është shpallur shoqëria “Alpen Pulito” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 09.03.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 518 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/2937, e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, më anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e shoqërisë “Alpen Pulito” SHPK dhe “EGIAN MED” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 518/2 prot., datë 10.03.2023 lidhur me kriteret mbi të cilat ngrihen pretendime për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Alpen Pulito” SHPK dhe “Egian Med” SHPK.

II.7. Me datë 13.03.2023, operatori ekonomik “Egian Med” SHPK ka paraqitur argumentet e tij pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues

“Pastrime Silvio” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera ka argumentuar si në vijim: “...1. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

“Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9”

Argumentojmë se, në lidhje me plotësimin e kriterit të mësipërm, kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “FORMULARI 1 VETDEKLARIMIT SHTOJCE NR 9” i cili është plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara në këtë format dhe sigurisht që kjo shtojce është sipas shtojcës Nr.9 të DT, pjesë e dokumenteve të tenderit të publikuar nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit: “Shërbim Dezinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektim” për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”.

Sa më sipër pretendimi i shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK për këtë kriter nuk qëndron.

2. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

[..2. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a) 1 (një) Drejtues Teknik. Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- Diplomë me profesion Shëndet Publik/Biologji/Kimi.

- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Të paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e - albania.

- Kontratë pune përkatëse.

- Librezë Pune, ose çdo Dokumentacion që vërteton eksperiencën përkatëse.

b) Minimalisht 2 (dy) Kontrollorë, sipas profileve të mëposhtme:

- Kontrollorë për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;

- Kontrollorë për kryerjen e kalibrimit të pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;

- Për punonjësit e percaktuar në piken b) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune..

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, dëshmon se punonjësit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi).

Argumentojmë se, Shoqëria “EGIAN MED” SHPK ha dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë kriter nga AK-ja e konkretisht në përmbushje të kriterit të mësipërm kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentet e emërtuara si më poshtë vijon;

1- “Diploma Niveli II A. Rr”, dokumenti i diplomës së nivelit të dytë për degën “KIMI” për drejtuesin teknike të shoqërisë Znj. A. Rr;

2- “Diploma e nivelit I Adela Rrjollit e noterizuar” dokumenti i diplomës së nivelit të parë, për degën “KIMI USHQIMORE” për drejtuesin teknike të shoqërisë Znj. A. Rr;

3- “Kontrata e punës A. Rr drejtuese teknike kimiste”;

4- “DREJTUESI TEKNIK DOKUMENTACIONI” dokumentacion për drejtuesin tjetër teknik të shoqërisë.

5- “Libreza e punës A. Rr”, pra libreza e punës së drejtueses teknike “kimiste” e cila vërteton se është e punësuar pranë “Egian Med” SHPK që nga data 23.02.2019;

6- Listëpagesa 20230126 (1), e cila vërteton se Znj. A. Rr është e punësuar si drejtuese teknike të shoqërisë;

7- “Vërtetim kontributesh A. Rr” dokument i cili vërteton se eksperiencën minimalisht 2 vjeçare për Znj. A. Rr, drejtuesin teknike “KIMISTE” të shoqërisë;

8- Gjithashtu në lidhje me plotësimin e kriterit të mësipërm, kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “FORMULARI I VETDEKLARIMIT SHTOJCA NR 9” i cili është plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara në këtë format e konkretisht për statin e kërkuar në kriterin e mësipërm kemi deklaruar si më poshtë:

Numri i punonjësve:

18 (tetëmbëdhjetë) gjithsej Profili i punonjësve

Nr. Emri dhe mbiemri Profesion/pozicioni i punës në shoqëri

1. A. Rr (Xh), Drejtues teknik i shoqërisë, i diplomuar “kimi ushqimore”; me diplomë specializimi “Kimist ushqimor”

2. Y. T. -Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

3. Xh. S. - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D, D.D

4. A. D - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

5. E. S - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

6. Y. Ç - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

7. R. Z - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

8. O. D - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D

8. T. L - Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikatë kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D dhe me certifikata mbi trajnimet e realizuara për përdorimin e pajisjeve të ndryshme, si dhe për kualidues dhe kalibrues i tyre.

Pra nga 2 (dy) punonjës të kërkuar kemi deklaruar se kemi 8 (tetë) punonjës të cilët e plotësojnë kriterin në pikën 2/b) për të cilën kemi dorëzuar në SPE dhe dokumentat e emërtuara:

...

Për gjithë sa më sipër pretendimi i ankuesit për mospermbushje të kritereve të mësipërme nuk qëndrojnë.

III. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

? Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr. Emer Mbiemer Profesion Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shënim 1:

Me qellim garantimin e gjithëperfshirjes, për ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik për te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperme jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës..

Argumentojmë se, Shoqëria “EGIAN MED” SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë kriter nga AK-ja e konkretisht në përmbushje të kriterit të mësipërm kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “Deklarata mbi stafin” i cili është sipas formatit të kërkuar nga AK-ja. Të dhënat e deklarura në këtë deklaratë përputhen me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në këtë procedurë.

Për gjithë sa mësipër pretendimi i ankuesit për mospërmbushje të kriterit të mësipërm nuk qëndron.

IV. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

3. Operatori ekonomik në lidhje me lenden e percaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqese, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent.

Shoqëria “EGIAN MED” SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë kriter nga AK-ja e konkretisht në përmbushje të kriterit të mësipërm kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “Deklarata mbi produktet PIKA 3” i cili është sipas formatit të kërkuar nga AK-ja në dokumentat e tenderit në shtojcën 8 të saj dhe në përputhje me sqarimin e dhënë nga autoriteti kontraktor më datë 26.01.2023, sqarim i dhënë në përgjigje të një kërkesë për sqarim në lidhje me këtë kriter.

Një OE ka kërkuar në SPE sqarim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

“... Sa më sipër, nisur nga fakti se për produktet biocide nuk lëshohen certifikata konformiteti apo certifikata cilësie CE, sqarimin tuaj se çfarë dokumenti konkret duhet paraqitet nga ana jonë me qëllim përmbushjen e këtij kriteri për kualifikim? A konsiderohet nga ana juaj, dokument ekuivalent në këtë rast, dokumentacioni i cili përcaktohet në ligjin e posaçëm e konkretisht në Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, dokumentet e mëposhtme:

- MSDS e produktit?

- Etiketa e tij;

apo Autorizimi për vendosjen e tij në treg apo leja e importit e lëshuar nga autoriteti kompetent? Lutemi sqarimin tuaj duke përcaktuar dokumnetin konkret që duhet të dorëzohet nga ana jonë...”
AK-ja ka sqaruar të gjithë OE-të si më poshtë:

“Në vijim të kërkesës tuaj për sqarim, ju sqarojmë të paraqitet dokumentacioni në përputhje me ligjin në fuqi.”

Nga AK-ja është kërkuar vetëm deklarimi dhe jo dokumentat konkrete të cilat kompania jonë do t'ja dergojë AK-së nëse na kërkohet nga ky autoritet sipas afatevc dhe përcaktimeve të ligjit të prokurimit publik,

Për gjithë sa mësipër pretendimi i ankuesit për mospërmbushje të kriterit të mësipërm nuk qëndron.

V. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

Operatori ekonomik duhet të deklaroj se **disponon, pajisjet dhe mjetet**, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1.	Pompë me presion	copë	2	Në pronësi ose me qira
2.	Cantë shpine me presion	copë	2	Në pronësi ose me qira

Argumentojmë se, shoqëria “EGIAN MED” SHPK, ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë kriter nga AK-ja e konkretisht, në përmbushje të kriterit të mësipërm kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “Deklarata e mjeteve” me përmbajtjen si më poshtë:

1. Stacionet profesionale me siguresa dhe mbishkrimin (Kuti Miu) – 2.000 (dy mijë) copë, Profatura X/X, datë 18.11.2020.

2. Pompa ULV – 11 (njëmbëdhjetë) – Fatura nr. X, datë 01.07.2020.

3. Automjetet për lëvizjen e punojësve dhe pajisjeve tip ATV me targa: AAXXXLX

AAXXXDV – 2 (dy) copë – Certifikatë pronësie datë 10.07.2020, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shqipëtar

4. Pompa për spërkatje “Batory sprayers series” – 12 (dymbëdhjetë) copë – Fatura nr. X, datë 02.03.2020.

5. Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë (Cold Fogging) ELITE 343-400 e vendosur në automjetin me targa AAXXXDO – 1 (një) Çertifikata c pronësisë se mjetit rrugor, dokumentacioni teknik, Akt zhdoganimi për gjenrator ELITE 340-400.

6. Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë (Cold Fogging) automizator e vendosur në automjetin me targa AAXXXHV City 325-35 HP 1 (një) - Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor, dokumentacionin teknik, Akt zhdoganimi për gjenrator dhe foto.

6. Automizator për granula - 3(tre) - Fatura nr.X datë 01.08.2021

7. Automizator për likuid – 1 (një) - Fatura nr.X, datë 01.08.2021

Pra kompania jonë ka deklaruar se disponon shumë më tepër mjete dhe pajisje se sa kërkohen nga AK-ja në këtë kriter.

Deklarojmë me përgjegjshmëri se disponojmë të gjithë dokumentacionin e deklaruar për këto mjete dhe do ti vëmë në dispozicion të AK-së ose KPP-se nëse na kërkohet.

Për gjithë sa mësipër pretendimi i ankuesit për mospërmbushje të kriterit të mësipërm nuk qëndron.

VI. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentojmë se, shoqëria “EGIAN MED” SHPK, ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë kriter nga AK-ja e konkretisht, në përmbushje të kriterit të mësipërm kompania jonë ka dorëzuar në SPE dokumentin e emërtuar “Deklarata sipas pikës 8” deklaratë në të cilën

shoqëria jonë deklaron se: “... Merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë?”

Për gjithë sa mësipër pretendimi i ankuesit për mospërbushje të kriterit të mësipërm nuk qëndron.

VII. Në lidhje me plotësimin e kriterit të mëposhtëm:

“Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Egian Med” SHPK, pasi: - Është ofertë anomalisht e ulët..”

Pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi:

Vlera e ofertuar nga ana jonë është 2.192.104 leke 9pa-TVSH) dhe referuar formulës së përlllogaritjes së ofertave anomalisht të ilëta rezulton se oferta jonë nuk është anomalisht e ulët, pasi ajo nuk është më e ulët se 85% e mesatares se ofertave të vlefshme.

Konkretisht: $85\% \text{ e MO} = 85\% * 2.357.023,33 = 2.003.469,83$ leke se oferta e “Egian Med” SHPK e cila është 2.192.104 leke pa-TVSH.

VIII. Në lidhje me deklaratimet e mëposhtëme;

- Ky operator paraqet dokumentacion jo të njëjtë me origjinalin (të ndryshuar).
- Nuk përputhet dokumentacioni i pajisjeve që disponon, skadat teknike me faturat e blerjeve/zhdoganimit.
- OE “Egian Med” ka qenë disa herë i përjashtuar nga APP për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për paraqitje të dokumentacionit të rremë apo të pavërtetë. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj, që të verifikoni edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik

Në radhë të parë shoqëria “EGIAN MED” SHPK nuk është e përjashtuar nga APP-ja dhe për më tepër nuk është marrë asnjëherë vendim për përjashtim nga pjesëmarrja në procedura prokurimi nga Agjencia e Prokurimit Publik, fakt të cilin e di shumë mirë edhe vetë ankimuesi. Përjashtimet e operatorëve ekonomikë nga Agjencia e Prokurimit Publik shpallen në faqen ëeb të APP-së.

Për këto deklaratime të cilat bëhen qëllimisht për të prishur imazhin e shoqërisë tonë, ne do të ndjekim rrugët e tjera ligjore kundra këtij operatori ekonomik i cili në mënyrë të papërgjegjshme bën deklaratatë të tilla të cilat tashme janë publike dhe prishin imazhin e shoqërisë tonë për fakte dhe deklaratime që dihen që nuk janë të vërteta.”..

II.8. Me shkresën nr. 392/4 prot, datë 21.03.2023 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt; ‘Shërbim Dezinfektim, Deratizim, Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh” protokolluar me tonën me nr. 518/4 prot, datë 24.03.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor nr. 393/1 prot, datë 20.03.2023, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur

nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 09.03.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 524 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/2940, e operatorit ekonomik “*EGIAN MED*” SHPK, më anë të së cilës kundërshton vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e shoqërisë “*Alpen Pulito*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 524/2 prot., datë 10.03.2023 lidhur me kriteret mbi të cilat ngrihen pretendime për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “*Alpen Pulito*” SHPK.

II.11. Me shkresën nr. 392/4 prot, datë 21.03.2023 me objekt: “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt; “Shërbim Dezinfektim, Deratizim, Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh*”, protokolluar me tonën me nr. 518/4 prot, datë 24.03.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor nr. 392/2 prot, datë 20.03.2023, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*EGIAN MED*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.12. Nëpërmjet vendimit Nr. 289/2023, me nr. 518/5 prot., datë 19.04.2023, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi shoqërisë “*EGIAN MED*” SHPK paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar të tij, brenda datës 24.03.2023, në përmbushje të kërkesave autoritetit kontraktor, të parashikuara në pikën 2.3.2 dhe pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Shërbime marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomike, ku të gjitha janë të përcaktuara, me afat 24 Muaj*”, me Nr. REF-48360-11-02-2022, me objekt: “*Shërbim Dezinfektimi, Deratizim, Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh*”, me fond limit të lotit 3.232.130 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.13. Në datën 24.04.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik nga shoqëria “*EGIAN MED*” SHPK dokumentacioni i këtij të fundit, në përgjigje të Vendimit Nr. 289/2023, me nr. 518/5 prot., datë 19.04.2023 të KPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Lidhur me kualifikimin e ofertës së OE “Egian Med” SHPK, e kundërshtojmë për këto arsye:

Nga eksperiencia që kemi me këtë operator, nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të mëparshme, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator është i parregullt dhe i paplotë. Së pari, ky operator nuk plotëson ose plotëson në mënyrë të gabuar Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9”.

Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, si më poshtë:

Shtojca 9.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. *Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
2. *Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
3. *Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
4. *Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
5. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
 - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
 - a) *çmimet ;*
 - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe

Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës"

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit, të plotësuar në të gjitha rubrikat e kërkuara në këtë formular duke bërë deklarinimet e kërkuara, si dhe janë cituar personi me inicialet F.L në cilësinë e Administratorit, si dhe personi me inicialet A.F në cilësinë e ortakut të vetëm të operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.4 Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistroheshin në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur 8 duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatorët ekonomikë “Egian Med” SHPK, me qëllim vërtetimin mbi plotësimin e saktë të Formularit të Vetëdeklarimit, ku kjo shoqëri ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, shtojcë e cila është plotësuar në të gjitha rubrikat e saj, duke bërë deklaratet përkatëse për sa i përket; “Informacionit në lidhje me operatorin ekonomik; Deklaratës për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme; Deklaratës për dorëzimin e ofertave të pavarura; Deklaratës mbi konfliktin e interesit; Deklarata për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës; Deklarata në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës dhe Deklarata për deponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme.”, si dhe kjo shtojcë është firmosur nga administratori i shoqërisë dhe vulosur me vulën e kompanisë.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “Së pari, ky operator nuk plotëson ose plotëson në mënyrë të gabuar Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit.”, Komisioni gjykon se ky pretendim i ankimuesit nuk qëndron, pasi nga shqyrtimi i Shtojcës 9 “Formular përmbledhës i vetëdeklarimit” të dorëzuar nga ana e ofertuesit “Egian Med” SHPK, u konstatua se është plotësuar në mënyrë të rregullt në të gjitha rubrikat e tij sikurse parashikohet në përcaktimet e nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Lidhur me kualifikimin e ofertës së OE “Egian Med” shpk, e kundërshtojmë për këto arsye:

Nga eksperiencia që kemi me këtë operator, nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të mëparshme, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator është i parregullt dhe i paplotë. Së treti, ky operator nuk e plotëson kriterin për zotërimin e punonjësve të kërkuar pasi, nuk i ka ato kapacitete.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të modifikuara përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Diplomë me profesion Shëndet Publik /Biologji/Kimi.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë Pune, ose cdo Dokumentacion që vërteton eksperiencën përkatëse.

b) **Minimalisht 2 (dy) Kontrollorë, sipas profileve të mëposhtme:**

- Kontrollorë për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- Kontrollorë për kryerjen e kalibrimin e pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- Per punonjesit e percaktuar ne piken b) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e paisjeve dhe/ose prepareteve, si dhe kontrata pune..

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, dëshmon se punonjesit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi).

➤ Operatori ekonomik te paraqese deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shënim 1:

Me qellim garantimin e gjithe perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Licensë nr: LN-5393-06-2018, me kodin II.8.A, me objekt veprimtarie “Shërbime ekspertize higjeno-shëndetësore”, me afat vlefshmërie “Pa afat”, në emër të shoqërisë “Egian Med” SHPK
2. Licensë nr: LN-5148-05-2018, me kodin II.8.B, me objekt veprimtarie “Shërbime ndërhyrese higjeno-shëndetësore. (dezinfektim, deratizim, dezinfektim)”, me afat vlefshmërie “Pa afat”, në emër të shoqërisë “Egian Med” SHPK
3. Deklaratë mbi stafin që disponon ku ka deklaruar se: “Deklarojmë se, shoqërisë “Egian Med” SHPK sipas nevojës dhe afateve të shërbimit të kërkuara nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh, do të angazhojë për realizimin e shërbimeve për tenderin me objekt

“Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me REF-48360-11-02-2022, punonjësit e mëposhtëm të cilët janë të trajnuar dhe të pajisur me certifikatat kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D ose dhe në përdorimin e pajisjeve për produktet DDD, sic është kërkuar nga ana juaj në dokumentat e tenderit, me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Profesioni/pozicioni i punës në shoqëri	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës në shoqëri
1	A.Rr (Xh)	Drejtues teknik i shoqërise, i diplomuar “Kimi ushqimore”; me diplomë specializimi “Kimist ushqimor”	23.02.2019
2	Y. T	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	01.11.2019
3	X. S	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	20.05.2020
4	A. D	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	14.09.2020
5	E. S	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	31.07.2021
6	Y. Ç	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	03.07.2021
7	R. Z	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	01.11.2019
8	O. D	Punonjës dezinfektimi, i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D	28.02.2019
9	T. L	Punonjës dezinfektimi i pajisur me certifikate kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Controll D.D.D dhe me certifikata mbi trajnimet e realizuara për përdorimin e pajisjeve te ndryshme si dhe për kualidues dhe	21.12.2019

	kalibrues i tyre	
--	------------------	--

4. Dokumentacionin e drejtueses teknike Znj. Adela Rrjoli (Xhuli), si më poshtë:

- Diplomë e nivelit të II në Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore, me numër matrikullimi: 88, lëshuar më datë 24.01.2011 nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, ku Znj. A. Xh diplomohet “Kimiste Ushqimore”.
- Diplomë e nivelit të I në Kimi Ushqimore, me numër amzës: XXXX, lëshuar më datë 26.11.2009 nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, ku Znj. A. Xh diplomohet në “Kimi Ushqimore”, e njehsuar më origjinalin.
- Librezë punë, në emër të Znj. A. Rr e firmosur nga shoqëria “Egian Med” SHPK, me numër regjistri themeltar nr. X, e çelur më datë 23.02.2019, ku pasqyrohet vetëm data e fillimit të marrëdhënieve të punës me këtë shoqëri dhe konkretisht më datë 23.02.2019, me pozicionin e punës “Drejtuese teknike”.
- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 23.02.2019, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit Znj. A. Rr, ku kjo e fundit është punësuar më detyrën e “Drejtuesit teknik” të shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Vërtetim për bazën e vlerësuar për Znj. A. Rr, me NID; i65809056P, e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku vërtetohet se ka qenë e punësuar dhe ka derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat si në vijim: “ Mars 2014 – shtator 2014; mars 2018 – dhjetor 2022;”.

5. Dokumentacionin e punonjësit z. Y. T, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 01.11.2019, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. Y. T, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXX, datë 08.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se Z. Y. T përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

6. Dokumentacionin e punonjësit z. Xh. S, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 20.05.2020, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. Xh. S, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXX, datë 08.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se Z. Xhedik Seli përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

7. Dokumentacionin e punonjësit z. A. D, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 14.09.2020, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. A. D, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 08.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me

licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se z. A. D përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

8. Dokumentacionin e punonjësit z. E. S, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 31.07.2021, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. E. S, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 05.05.2022, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se Z. Erjon Seli përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

9. Dokumentacionin e punonjësit z. U. Ç, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 03.07.2021, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. U. Ç, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 05.05.2022, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se z. U. Ç përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

10. Dokumentacionin e punonjësit z. T. L, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 21.12.2019, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. T. L, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 08.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se z. T. L përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.
- Vërtetim Trajnimi datë 07.03.2019, e lëshuar nga kompania “XXX XXX S.R.L, për z. T. L, ku vërtetohet se ka ndjekur kursin e trajnimit “Trajnim i teknikëve për përdorimn e aromatizuesve spray team, për trajtim me biocide; pompa çantë shpine, atomizues çantë shpime, i lëngshëm dhe me kokriza”, e përkthyer dhe noterizuar.
- Certifikatë me numër regjistri nr: XXX, i lëshuar nga shoqëria “Akademia e Shëndetit Publik LABYRINTH” me numër licence : LN-7108-12-2013, ku vërtetohet se z. T. L ka kryer kursin e trajnimit “Koalidues dhe kalibrues të pompave ULV dhe enëve në presion, cold fogging, shpërndarjen e përshtatshme të produkteve CectBac WG, VectBac G, VectoMax FG”.

11. Dokumentacionin e punonjësit z. R. Z, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 01.11.2019, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. R. Z, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 08.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se z. R. Z përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

12. Dokumentacionin e punonjësit z. O. D, si më poshtë:

- Kontratë individuale e punës e lidhur më datë 21.12.2019, midis punëdhënësit administratorit të shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe punëmarrësit z. O. D, ku ky i fundit është punësuar më detyrën e “Punonjës dezinfektimi” pranë shoqërisë, me afat “Pa afat”.
- Certifikatë kualifikimi nr. XXXX, datë 04.07.2020, e lëshuar nga shoqëria “Arli Internacional SHPK e licencuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me licencën nr; LN-6606-06-2013, ku vërtetohet se z. O. D përfundoi kursin “Në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim)”.

13. Deklaratë për produktet dhe stafin si më poshtë:

“Shoqëria “EGIAN MED” SHPK me NIPT/NUIS L71715003C, me objekt kryesor edhe në veprimtarisë e me objekt veprimtarie ndër të tjera edhe në fushën e shërbimeve nderhyrese higjeno sanitare shendetesore, shërbimeve Pest Control (DDD - Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2/b të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik, të shtojcës 8 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me REF-48360-11-02-2022, me fond limit: 3,232,130 (tre milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH., të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, deklararon se:

Në rast se shpallemi fitues të kësaj procedure prokurimi deklarojmë se, të gjithë punonjësit e shoqërisë “Egian Med” SHPK të cilët do të angazhohen në realizimin e shërbimeve për tenderin me objekt “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me REF-48360-11-02-2022, janë të trajnuar dhe të pajisur me certifikatat kualifikimi në përdorimin e produkteve Pest Control D.D.D të lëshuara nga shoqëria “ARLI INTERNACIONAL” SHPK, shoqëri e licensuar sipas ligjit nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe Rinisë, shoqëri e akredituar nga organizëm nderkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë ose dhe për përdorimin e pajisjeve për produktet DDD, sic është kërkuar nga ana juaj. Punonjësit janë të deklaruar me kodet respektive, konkretisht me kod.7544.”

14. Listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të muajit dhjetor 2022, ku vërtetohet se shoqëria ‘Egian Med’ SHPK në këtë muaj ka të punësuar 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës.

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rëndësi ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 41, pikat 2 dhe 4 të VKM r. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre ose të disponojnë në stafin e tyre 1 (një) person me detyrën e drejtuesit teknik e vërtetuar kjo me diplomë në njërin prej degëve “Shëndet Publik” ose “Biologji” ose “Kimi”, me eksperiencë pune jo më pak se 2 (dy) vjet e vërtetuar me paraqitjen e deklaratës së kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania, librezës së punës dhe kontratën e punës me shoqërinë që oferton, si dhe kërkon që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e tij ose të disponojë në stafin e tyre 2 (dy) punonjës ku njëri të jetë i trajnuar për kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit vërtetuar me certifikatë trajnimi dhe tjetri të jetë i trajnuar për operimin e pajisjeve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit ose i trajnuar për operimin e preparateve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit objekt-prokurimi. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ofertuesi “Egian Med” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi me dokumentacionin e dorëzuar vërteton që ka të punësuar në stafin e tij 1 (një) person me detyrën e drejtuesit teknik e vërtetuar kjo me diplomë e nivelit të parë dhe të dytë për kimi ushqimore në njërin prej degëve “Shëndet Publik” ose “Biologji” ose “Kimi”, me eksperiencë pune jo më pak se 2 (dy) vjet e vërtetuar me paraqitjen e deklaratës së kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania, librezës së punës dhe kontratën e punës me shoqërinë që oferton, si dhe kërkon që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e tij ose të disponojë në stafin e tyre 2 (dy) punonjës ku njëri të jetë i trajnuar për kalibrimin e pajisjeve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit vërtetuar me certifikatë trajnimi dhe tjetri të jetë i trajnuar për operimin e pajisjeve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit ose i trajnuar për operimin e preparateve që do të përdoren

për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit objekt-prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Egian Med” ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pinë 2.3.2 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Pastrime Silvio” SHPK për operatorin ekonomik “Egian Med” ShPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Lidhur me kualifikimin e ofertës së OE “Egian Med” ShPK, e kundërshtojmë për këto arsye:

Nga eksperiencia që kemi me këtë operator, nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të mëparshme, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator është i parregullt dhe i paplotë. Ky operator, nuk i disponon certifikatat e produkteve të deklaruara.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Operatori ekonomik në lidhje me lenden e përcaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqese, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësi CE/ekuivalent.

<i>Lenda që do të përdoret në shërbimin e dezinfektimit</i>			
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i produktit</i>	<i>Vendi i origjinës</i>	<i>Certifikatë konformiteti ose cilësi CE/ekuivalent</i>
<i>1</i>			
<i>2</i>			

Shënim:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qene pjese e planit të zbatimit të kontrates.

III.3.2. Në shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Dezinfektim i ambienteve të brendshme

Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të brendshme, të mbyllura, të institucioneve të ndryshme (psh: pavione shtrimi, zyra, ambiente pritje, korridore, tualete, magazina, arkiva, automjete, etj).

Të dhënat teknike të produkteve Biocide:

Dezinfektimi i ambienteve të brendshme duhet të kryhet me dezinfektant. Produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, duhet të rezultojnë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë vetëm “për përdorim profesional”.

Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë të përshtatshme për t’u aplikuar në ambiente të brendshme, të tilla si: godina institucionesh, gazerma, magazina, automjete, etj.

Produktet Biocide duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur në kohën e përcaktuar.

Produktet Biocide nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëze, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

Nuk duhet të përdoret asnjë produkt apo preparat që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem.

Shpeshësia e kryerjes së shërbimit: 3 (tre) herë në vit, ose sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

2. Dezinfektim i ambienteve të jashtme

Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të jashtme, të hapura, të institucioneve të ndryshme (psh: holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse - dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj).

Të dhënat teknike të produkteve Biocide:

Dezinfektimi i ambienteve të jashtme duhet të kryhet me dezinfektant. Produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, duhet të rezultojnë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë vetëm “për përdorim profesional”.

Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë të përshtatshme për t’u aplikuar në ambientet e jashtme të institucioneve, të tilla si: holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse - dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj.

Produktet Biocide duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur në kohën e përcaktuar.

Produktet Biocide nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëze, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

Nuk duhet të përdoret asnjë produkt apo preparat që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem.

Shpeshësia e kryerjes së shërbimit: 3 (tre) herë në vit, ose sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

“Shërbime dezinfektim dhe deratizim”

Sherbimi i dezinfektimit do të kryhet me insekticide per luftimin e insekteve zvarritese, fluturuese, akaridet dhe antropodet.

Insekticidet te cilat do te perdoren duhet te trajtojne te gjithë gamen e insekteve vektore per transmetimin e semundjeve nga viruset dhe bakteret te transmetueshem nga demtuesit.

Sherbimi i Dezinfektimit te hapsirave te jashtme kunder mushkonjave do te kryhet me insekticid adulticid ne sperkatje me pompe ne hapesirat e gjelberuara dhe muret rrethues ne mengjes ose ne oret e vona te mbremjes. Insekticidi i cili do te perdoret duhet te jete Pirotreid me baze deltametrine. Sherbimi i dezinfektimit kunder mushkonja do te kryhet ne muajt Prill, Mars, Qershor ose sipas nevojave te institucionit.

*Për kontrollin e insekteve zvarritëse në ambientet e pavioneve, zyrave etj., ... do të kryhet duke vendosur stacione monitorimi dhe do të përdoren produkte biocide Neuro Nikodoide me lëndë aktive **imidacloprid si dhe çdo produkt tjetër i ngjashëm/alternativ ose ekuivalent me të.** Shërbimi i kontrollit të insekteve zvarritëse do të kryhet gjatë gjithë periudhës së vitit minimalisht një herë në muaj.*

Sherbimi i kontrollit kunder brejteseve do te kryhet duke vendosur stacione monitorimi dhe stacione aplikimi te karremit. Stacionet e karremit do te vendosen cdo 10-20 metra te cilat duhet te jene te perbera prej materjali plastik polipropileni per vendosjen e karremeve rodenticiteve antikoagolante per te shmangur konsumimin e rodenticitit nga kafshet shtepiake apo endacake.

Karremi rodenticit i cili do te perdoret do te jete rodenticit antikoagolant me lende aktive kumatetralyl.

Sherbimi i kontrollit kunder brejtesave (Deratizimi) do te kryhet minimalisht cdo muaj dhe te rimbushen kutite çdo 14 dite nese verehet prezence e shtuar e brejtesve.

Preparatet që do të përdoren nuk duhet të jenë të dëmshme për njerezit, pasi duhet te trajtojne ambiente ku ka aktivitet njerëzor të shpeshtë.

Operatori ekonomik pas kryerjes së shërbimit duhet të pajisë me Certifikatën DDD Autoritetin Kontraktor gjithashtu me procesverbali e shërbimit ku te jene percaktuar qarte siperfaqet e trajtuara, produktet biocide te aplikuar dhe masen e aplikimit.

Skicimet, parametrat teknik te lendeve per perdorim ne shendetin publik (në kuptim te Ligjit 95/2015 dhe VKM-se nr.933 date 25.11.2020) :

Preparat për dezinfektim. Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj. Destinacioni i përdorimit: Në ambiente të brendshme, të jashtme si zyra, rrugë, sheshe publike, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj. ***Jetëgjatësia:*** jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. ***Si dhe çdo produkt tjetër i ngjashëm/alternativ ose ekuivalent me te.***

Preparat për dezinfektim. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra etj.). Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij

minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. **Si dhe çdo produkt tjeter i ngjashem/alternativ ose ekuivalent me te.**

Preparat për dezinfektim në ambiente sensitive. Insekticid natyral për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambiente sensitive (kuzhina, mensa etj.) ose me veprime mekanike/kurthe monitorimi. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. **Si dhe çdo produkt tjeter i ngjashem/alternativ ose ekuivalent me te.**

Preparat për luftimin e furrtareve. Insekticid për luftimin e insekteve. Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. **Si dhe çdo produkt tjeter i ngjashem/alternativ ose ekuivalent me te.**

Preparat për luftimin e minjve. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbyllura ose me veprime mekanike/kurthe monitorimi. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. **Si dhe çdo produkt tjeter i ngjashem/alternativ ose ekuivalent me te.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Lëndët aktive bazë për produktet e shërbimit DDD janë përzgjedhur me qëllim aplikimin në ambiente të jashtme e të brendshme, të tilla si godina institucionesh, magazina, sheshpushime, vendqëndrime me dendësi të lartë të veprimtarisë njerëzore, mjedise të ndotura, etj. Produktet duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicide dhe virusicid të zgjatur, nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis. Lëndët aktive për produktet e Dezinfektimit dhe Deratizimit janë përzgjedhur si rrjedhojë e ndryshimit të lëndëve aktive në përdorim për një kohë të gjatë, me qëllim pakësimin e rezistencës ndaj produkteve kimike të insekteve dhe brejtësve. Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 487, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Dezinfektimi duhet të kryhet sipas nevojave specifike të ambientit dhe ekspertizës higjieno-sanitare të ofruar nga operatori ekonomik, nëpërmjet mënyrave, si psh :

- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, që garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht ambiente të vogla zyrash, automjete, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / etj).
- me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht për spërkatje sipërfaqesh dyshemeje, muresh të jashtme, muresh rrethuese, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / mjete lëvizëse / etj);
- me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht sipërfaqe dyshemeje, muresh, mobiljesh, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / etj).

- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, që garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht ambiente të vogla zyrash, automjete, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / etj).
- me spërkatje mjegulluese në të nxehtë, minimumi 10 metra largësi (kryesisht për sipërfaqe rrugica hyrëse - dalëse, sheshe pushimi, holle të hapura, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / mjete lëvizëse / etj).

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Deklaratë të datës 30.01.2023, të lëshuar nga administratori i shoqërisë, ku deklarohej se:

Lenda që do të përdoret në shërbimin e dezinfektimit			
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE / ekuivalent (dokumentacioni që verteton përmbushjen e kërkesave të Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe të VKM nr. 933, datë 25.11.2020 “Përpërcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”)
1	- XXXXXXX ose - XXXXXXX XXXXX ose	XXXXX XXXXXX	Çertifikatë tregëtimi , lëshuar nga autoritet kompetent shqiptar si dhe dokumentacioni që i paraprin marrjes së këtij autorizimi si psh: MSDS; Çertifikatë origjinë. Etiketa e produktit; etj

III.3.4. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.3.5. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.3.6. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.7. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.8. Në nenin 41 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.3.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të

modifikuara ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë në lidhje me lëndën e përcaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqesë duke plotësuar tabelën e dhënë në këtë kriter, duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikatë konformitetit ose certifikatën e cilësisë CE ose ekuivalentet e tyre. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Egian Med” ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur deklaratën e administratorit të shoqërisë sikurse është kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, duke deklaruar natyrën e produkteve biocide që do të përdoren për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, duke deklaruar vendin e origjinës së këtyre produkteve, si dhe certifikatën e tregtimit të produktit biocid (ekuivalente me certifikatën e konformitetit dhe certifikatën CE) të lëshuar nga autoriteti kompetent shqiptar si dhe dokumentacioni që i paraprin marrjes së këtij autorizimi si psh: MSDS; Certifikatë origjinë. Etiketa e produktit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Egian Med” ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Pastrime Silvio” SHPK për operatorin ekonomik “Egian Med” ShPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Lidhur me kualifikimin e ofertës së OE “Egian Med” ShPK, e kundërshtojmë për këto arsye:

Nga eksperiencia që kemi me këtë operator, nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të mëparshme, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator është i parregullt dhe i paplotë. Gjithashtu, ky operator nuk i disponon pajisjet e kërkuara për kryerjen e këtij shërbimi.”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.6 të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

6. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se **disponon, pajisjet dhe mjetet, si më poshtë:**

<i>Nr</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasi të minimale</i>	<i>Statusi</i>
1.	<i>Pompe me presion</i>	<i>copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
2.	<i>Cantë shpine me presion</i>	<i>copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Deklaratë të datës 30.01.2023, të lëshuar nga administratori i shoqërisë, ku deklorohet se:

	<i>Emërtimi i mjetit/ pajisjes</i>	<i>Sasia</i>	<i>Dokumentacioni i pronësisë / qirasë</i>
	<i>Stacionet profesionale me siguresa dhe</i>	<i>2,000(dy mijë) copë</i>	<i>Profatura XX, datë 18.11.2020</i>

	<i>mbishkrim (Kuti miu)</i>		
	<i>Pompa ULV</i>	<i>11(njëmbëdhjetë)</i>	<i>Fatura nr.X datë 01.07.2020</i>
	<i>Automjet për lëvizjen e punonjësve dhe pajisjeve Tip ATP me targa:</i> <i>1- AAXXXLX</i> <i>2- AAXXXDV</i>	<i>2(dy) copë</i>	<i>Certifikatat e pronësisë, datë 10.07.2020, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shqipëri.</i>
	<i>Pompa për spërkatje ‘Bateri sprayer series’</i>	<i>12(dymbëdhjetë) copë</i>	<i>Fatura nr.X datë 02.03.2020</i>
	<i>Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë(Cold Fogging) ELITE 343-400 e vendosur në automjetin me targa AAXXXDO</i>	<i>1(një)</i>	<i>Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor, dokumentacioni teknik, AKTZHDOGANIMI PER GJENERATOR ELITE 343-400</i>
	<i>Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë (Cold Fogging) automatizator e vendosur në automjetin me targa AAXXXHV City 325- 35 HP</i>	<i>1(një)</i>	<i>Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor, dokumentacioni teknik, AKTZHDOGANIMI PER GJENERATOR dhe foto.</i>
	<i>Automizator për granula</i>	<i>3(tre)</i>	<i>Fatura nr.X datë 01.08.2021</i>

III.4.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.4.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.4.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.7. Në nenin 41 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;*

d) *në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.4.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.4.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuar ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë në lidhje me disponimin e pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi dhe konkretisht disponimin me një nga format që nje ligji, në pronësi ode me qira të 2 (dy) pompa me presion dhe 2 (dy) çanta shpine me presion. Nga verifikimi i dokumentacionit

të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Egian Med” ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur deklaratën e administratorit të shoqërisë sikurse është kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, duke deklaruar se disponon në një rën nga format ligjore të përcaktuara nga autoriteti kontraktor të pajisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi si në vijim: “11 (njëmbëdhjetë) copë Pompa ULV; 12 (dymbëdhjetë) copë Pompa për spërkatje “Batory sprayer series”; 1 (një) Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë (Cold Fogging) ELITE 343-400 e vendosur në automjetin me targa AA803DO; 1 (një) Pompë mjegulluese dezinfektimi me presion të lartë (Cold Fogging) automatizator e vendosur në automjetin me targa AA937HV City 325- 35 HP; 3 (tre) Automatizator për granula dhe 1 (një) Automatizator për likuid”. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Egian Med” ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Pastrime Silvio” SHPK për operatorin ekonomik “Egian Med” ShPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Lidhur me kualifikimin e ofertës së OE “Egian Med” ShPK, e kundërshtojmë për këto arsye:

Nga eksperiencia që kemi me këtë operator, nga pjesëmarrja në procedura prokurimi të mëparshme, dokumentacioni i dorëzuar nga ky operator është i parregullt dhe i paplotë. Së treti, ky operator nuk e plotëson kriterin për zotërimin e punonjësve të kërkuar pasi, nuk i ka ato kapacitete.3”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.8 të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Deklaratë të datës 30.01.2023, të lëshuar nga administratori i shoqërisë, ku deklarohej se: “Shoqëria “EGIAN MED” SHPK me NIPT/NUIS L71715003C, me objekt kryesor edhe në veprimtarisë e me objekt veprimtarie ndër të tjera edhe në fushën e shërbimeve nderhyrese higjieno sanitare shendetesore, shërbimeve Pest Control (DDD - Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 8 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik, të shtojcës 8 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me REF-48360-11-02-2022, me fond limit: 3,232,130 (tre milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë)

Lekë pa TVSH., të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, deklaroi se:

Merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.”.

III.5.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.5.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.5.5. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurorë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.5.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.5.7. Në nenin 41 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.5.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e

veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.5.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuar ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë në lidhje zotimin e tij dhe marrjen e përgjegjësisë, se merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik "Egian Med" ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur deklaratën e administratorit të shoqërisë sikurse është kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, duke deklaruar se merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik "Egian Med" ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK për operatorin ekonomik "Egian Med" ShPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë "EGIAN MED" SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: "*Është ofertë anomalisht e ulët*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Nga verifikimet në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se në datën 16.02.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "Alpest" SHPK	0,00 lekë	skualifikuar
2. "AIR" SHPK	975.000,00 lekë	skualifikuar
3. "ALPEN PULITO" SHPK	1.679.084,40 lekë	kualifikuar
4. "Metani Green" SHPK	1.959.022,00 lekë	skualifikuar
5. "EGIAN MED" SHPK	2.192.104,00 lekë	kualifikuar
6. "LOERMA" SHPK	2.244.952,00 lekë	skualifikuar
7. "Pastrime Silvio" SHPK	3.199.882,00 lekë	kualifikuar

III.6.2. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se:

"1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]"

III.6.3. Në nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

"6. Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

-Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPPsë, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së."

III.6.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i procesit të vlerësimit të ofertave dhe në veçanti nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar ofertat e 3 (tre) operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimimi nga ku oferta ekonomike e shoqërisë “Egian Med” SHPK me vlerë 2.192.104 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, nuk rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e ofertës ekonomike të këtij operatori ekonomik është më e madhe se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, e cila është në vlerën 2.003.469,94 lekë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Pastrime Silvio” SHPK për operatorin ekonomik “Egian Med” ShPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Nuk përputhet dokumentacioni i pajisjeve që disponon, skedat teknike me faturat e blerjeve/zhdoganimit”*, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në dokumentet e tenderit kërkesë për kualifikim lidhur me faktin se ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e pajisjeve që disponojnë për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi dhe konkretisht skedat teknike, si dhe këto skeda teknike duhet të përputhen me dokumentacionin e disponimit të këtyre pajisjeve sikurse është fatura e blerjes ose akti i zhdoganimit.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. vëren se:

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Pastrime Silvio” SHPK për operatorin ekonomik “Egian Med” ShPK nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “EGIAN MED” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Ky operator paraqet dokumentacion jo të njëjtë me origjinalin (të ndryshuar). OE “Egian Med” ka qenë disa herë i përjashtuar nga APP për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për paraqitje të dokumentacionit të rremë apo të pavërtetë. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj, që të verifikoni edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. *Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e*

prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;
- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;
- c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.8.2. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.8.3. Neni 48 pika 3 “Kushtet formale të ankesës” të Vendimit Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” përcaktohet se:

“3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

- a. provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni i Prokurimit Publik;
- b. kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;
- c. kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.”.

III.8.4 Referuar ankesës së operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për skualifikim e shoqërisë ofertuese “Egian Med” SHPK pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues, në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së, nuk parashtron fakte konkrete apo dyshime të bazuara dhe të argumentuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime dhe hamendësime, lidhur me paraqitjen e dokumentacioni jo të njëjtë me origjinalin (të ndryshuar) nga ana e shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe se ky i fundit ka qenë disa herë i përjashtuar nga APP për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për paraqitje të dokumentacionit të rremë apo të pavërtetë, prandaj kërkon që të verifikohet edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, (cituar ankesa në pikën III.8.).

Referuar Vendimit Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit të afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3: - Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

III.8.5. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik. Operatori ekonomik ka detyrimin që t’i bëjë të identifikueshme pretendimet e tij mbi shkeljet, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku i bazon pretendimet e tij për mospërmbushje të kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë, se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.8.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit qëndron mbi ankimuesin. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit ekonomik dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro-aktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv në pritje të argumenteve të plota provuese se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve

të tjerë ekonomike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të përgjithshme apo edhe të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument konkret se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”, përcakton një ndër parimet kryesore të së drejtës që është ai se “onus probandi incumbit actori”, se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.8.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë, e si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Referuar arsytimit më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egjan Med” SHPK nuk merren në shqyrtim.

III.9. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvo” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alpen Pulito” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.9.1. Parashikimi i nenit 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.9.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.9.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi, është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” ShPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi, se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 16.02.2023 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Egian Med” ShPK, mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, në rastin konkret për operatorin ekonomik “Alpen Pulito” ShPK nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “Alpen Pulito” SHPK nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Alpen Pulito” SHPK, pasi është: -Ofertë anomalisht e ulët.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1 Në shtojcën 2 të dokumenteve të tenderit përcaktohet si më poshtë:

<p>Shtojca 2.</p> <p align="center"><i>(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)</i></p> <p align="center">LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE</p> <p align="center">“Shërbim Dezinfektim Deratizim Dezisektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”</p>						
<p>Data: _____</p>						
<p>Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____</p>						
<p>Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):</p> <p>_____</p>						
<p>Monedha: _____</p>						
<p><i>Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.</i></p>						
<p><i>Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.</i></p>						
<p><i>Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.</i></p>						

LISTA E ÇMIMEVE

SHËRBIM DEZINFEKTIM, DERATIZIM, DEZINSEKTIM” PËR DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR, GRAMSH						
Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia totale e shërbimeve	Numri total i trajtimeve për 24 muaj	Cmimi për njësi Lekë (pa TVSH)	Vlera Totale Leke (pa TVSH)

				(herë)		
1	Dezinsektim i ambienteve të brendshme spitalore	m2	5509	6		
2	Dezinsektim i ambienteve të jashtme spitalore	m2	5981	6		
3	Dezinsektim i ambienteve te brendshme	m2	5509	2		
4	Dezinsektim i ambjenteve te jashtme spitalore	m2	5981	2		
5	Deratizim i ambjenteve te brendshme spitalore	m2	2194	2		
Fondi i Marreveshjes Kuader Leke (pa TVSH)					3,232,130 Lekë (pa TVSH)	
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

III.10.2. Në shtojcën 5 “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*” në dokumentet e tenderit përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Dezinsektim, Deratizim, Dezinsektim.

Afatet e ekzekutimit:

“SHËRBIM DEZINFEKTIM DERATIZIM DEZINSEKTIM” PËR DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR, GRAMSH.				
Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia totale e shërbimeve	Numri total i trajtimeve për 24 muaj (herë)
1	<i>Dezinsektim i ambienteve të brendshme spitalore</i>	<i>m2</i>	<i>5509</i>	<i>6</i>
2	<i>Dezinsektim i ambienteve të</i>	<i>m2</i>	<i>5981</i>	<i>6</i>

	<i>jashtme spitalore</i>			
3	<i>Dezinsektim i ambienteve te brendshme</i>	<i>m2</i>	<i>5509</i>	<i>2</i>
4	<i>Dezinsektim i ambienteve te jashtme spitalore</i>	<i>m2</i>	<i>5981</i>	<i>2</i>
5	<i>Deratizim i ambienteve te brendshme spitalore</i>	<i>m2</i>	<i>2194</i>	<i>2</i>

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, brenda marreveshjes kuader.

III.10.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 242/4 datë 24.02.2022, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Adenis Kastrati” Pf është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO nëpërmjet seksionit kërkesa të sistemit të prokurimeve elektronike, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.10.4. Në përgjigje të kërkesës së KVO më datë 13.02.2023 operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur në mënyrë elektronike dokumentacionin si më poshtë:

Bazuar në ofertën e paraqitur në datën 30 Janar 2023, për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh” ju saktësojmë si më poshtë zgjidhjen ekonomike:

1. Për shërbimin dezinfektim të ambienteve të brendshme spitalore me numër trajtimi për 24 muaj 6 herë dhe me vlerë totale pa TVSh xxx,xxx lek , ju sqarojmë se kostoja e produkteve është 273,517 lek, fuqia punëtore + sigurimet shoqërore janë 213,818 lek për 6 trajtime. Fitimi i kompanisë është 82,847 lek,

Totali 570182 / 5509 m2 / 6 = 17.25 lek / m2. Baza materiale si më poshtë:

- *Xxxx - 40 kg*
- *Xxxx - 25 cope*
- *Xxxx - 12 kg*
- *Xxxx - 20 lit*
- *Xxxx - 179 cope*
- *Xxxx - 61 kg*
- *Xxxx - 6 lit*
- *Xxxx - 10 kg*
- *Xxxx - 36 kg*
- *Xxxx - 91 lit*
- *Xxxx - 100 kg*
- *Xxxx - 180 kg*
- *Xxxx - 33 cope*
- *Xxxx - 2 cope*

2. Për shërbimin dezinfektim të ambjenteve të jashtme spitalore me numër trajtimi për 24 muaj 6 herë dhe me vlerë totale pa tvsh xxx.xxx lek ju sqarojmë se kostoja e produkteve është xxx.xxx lek, fuqia punëtore sigurimet shoqërore janë xxx.xxx lek për 6 trajtime. Fitimi i kompanisë është xx.xxx lek.

Totali xxx.xxx / 5981 m² / 6 = xx,xx lek / m².

- Xxx - 44 kg
- Xxx - 25 cope
- Xxx - 12 kg
- Xxx - 30 lit
- Xxx - 200 cope
- Xxx - 61 kg
- Xxx - 6 lit
- Xxx - 10 kg
- Xxx - 36 kg
- Xxx - 98 lit
- Xxx - 120 kg
- Xxx - 180 kg
- Xxx - 33 cope
- Xxx - 2 cope

3. Për shërbimin dezinfektim i ambjenteve të brëndshme me numër trajtimi për 24 muaj 2 herë dhe me vlerë totale pa tvsh xxx.xxx lek ju sqarojmë se kostoja e produkteve është xx.xxx lek, fuqia punëtore * sigurimet shoqërore janë xx.xxx lek për 2 trajtime. Fitimi i kompanisë është 27,616 lek.

Totali xxx.xxx / 5509 m² / 2 = xx,xx lek / m²

- Xxx - 33 lit
- Xxx - 5 bid
- Xxx - 24 kg
- Xxx - 10 lit
- Xxx - 39 lit
- Xxx - 3 lit
- Xxx - 10 cope
- Xxx - 10 kg

4. Për shërbim dezinfektim i ambjenteve të jashtme me numër trajtimi për 24 muaj 2 herë dhe me vlerë totale pa tvsh xxx.xxx lek ju sqarojmë se kostoja e produkteve është xx.xxx lek fuqia punëtore + sigurimet shoqërore janë xx.xxx lek për 2 trajtime fitimi i kompanisë është xx.xxx lek

Totali xxx.xxx / 5981 m² / 2 = xx,xx lek / m²

- Xxx - 20 lit
- Xxx - 3 cope

- Xxxx - 20 lit
- Xxxx - 10 lit
- Xxxx - 10 kg
- Xxxx - 10 cope
- Xxxx - 33 cope
- Xxxx - 1 cope
- Xxxx - 2 kg

5. Për shërbim deratizim i ambjenteve të brëndshme me numër trajtimi për 24 muaj 2 herë dhe me vlerë totale pa tvsh xx.xxx lek jua sqarojmë se kostoja e produkteve është xx.xxx lek fuqia punëtore sigurimet shoqërore janë xx.xxxx lek për 2 trajtime fitimi i kompanisë është xx.xxx lek

Totali xxx.xxx / 2194 m² / 2 = xx,xxx lek / m²

- Xxxx - 10 lit
- Xxxx - 20 cope
- Xxxx - 16 cope
- Xxxx - 16 cope
- Xxxx - 20 kg
- Xxxx - 7 kg
- Xxxx - 15 cope

Gjithashtu bashkëlidhur ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

Faturë blerje nr. XX, datë 23.03.2022, ku blerësi shoqëria “Alpen Pulito” SHPK ka blerë artikujt si në vijim: “RATIBROM paste 10; GEOTOX 5; KESTREL 5L; TAIFUN; MERPAN 10; PYRINEX 5; Ngjitese miu; DRAKER 1; MANFIL 75 WG 25 dhe COOPER BLAU 25.”.

Faturë blerje nr. XXX, datë 26.08.2022, ku blerësi shoqëria “Alpen Pulito” SHPK ka blerë artikujt si në vijim: “Ngjitese miu; KUTI MIU BIG; KALIF kunder gjarperit; SHERPA PRO BIOSULF; ORIUS 25 EW 5L; BELEM; KESTREL 5L dhe CALCIUM FERTILIZER.”.

Faturë blerje nr. XXX, datë 18.11.2022, ku blerësi shoqëria “Alpen Pulito” SHPK ka blerë artikujt si në vijim: “Quickphos dhe Cythrine.”.

Faturë blerje nr. XXXX, datë 08.11.2022, ku blerësi shoqëria “Alpen Pulito” SHPK ka blerë artikujt si në vijim: “FOVAL GEL 5; SHERPA PRO 5; Ngjitese miu dhe RATIBROM paste 10.”.

Faturë elektronike tatimore shitje nr. XXX, datë 29.08.2022, emëtuar nga shitësi “Alpen Pulito” SHPK për blerësin “Four Seasons Hotel & Resort”, me objekt: “Sherbim D.D.D (copë)- 24 copë”, me vlerë x.xxx.xxx leke pa-TVSH.

Faturë elektronike tatimore shitje nr. XXX, datë 10.08.2022, emëtuar nga shitësi “Alpen Pulito” SHPK për blerësin Bashkia Gramsh, me objekt: “Dezinfektimi i objekteve të shkollave, kopshteve, çerdhe, konvikt, p-kulture, QKT – 1 copë”, me vlerë 120.000 leke pa-TVSH.”.

Deklaratë doganorë importi IM4, me numër: R XXXXX, datë 15.10.2020, ku vërtetohet se shoqëria “Alpen Pulito”SHPK ka importuar në Republikën e Shqipërisë 10 (dhjetë) copë makineri dezinfektimi ULV të markës “Nebulo Fogger Gold”.

Deklaratë doganorë importi IM4, me numër: R XXXXX, datë 06.11.2020, ku vërtetohet se shoqëria “Alpen Pulito”SHPK ka importuar në Republikën e Shqipërisë 5 (pesë) copë makineri dezinfektimi ULV të markës “Nebulo Fogger Gold”.

Faturë tatimore shitje me numër serial: xxxxxxxx, datë 17.08.2010, ku vërtetohet se shoqëria “Alpen Pulito”SHPK ka blerë 1 (një) pompë me kapacitet 450 litra.

Faturë tatimore shitje me numër serial: xxxxxxxx, datë 14.07.2021, ku vërtetohet se shoqëria “Alpen Pulito”SHPK ka blerë 1 (një) pompë të llojit “Mistral”.

III.10.5. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.”.

III.1.6 Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.10.7. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Alpen Pulito” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 1.679.084,40 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre, që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën.

Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës.

Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë

rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit, në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP thekson, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike, përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.10.8. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezultojnë, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues, si më poshtë:

- Argumentimin e ofertës në mënyrë narrative, lidhur me *mënyrë dhe anën ekonomike të metodës së shërbimeve të ofruara, pasi ndonëse ka paraqitur anën ekonomike të metodës së ndërtimit të kostos për secilin nga shërbimet objekt-prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit, por pa argumentuar në mënyrën të detajuar këtë anë ekonomike, pasi nuk ka detajuar numrin e fuqisë punëtore dhe kohëzgjatjen e punës për realizimin e këtyre shërbimeve në mënyrë që të llogaritet kosto e fuqisë punëtore për realizimin e këtyre shërbimeve, por vetëm ka detajuar sasinë dhe llojin e produkteve të nevojshme për realizimin e këtyre shërbimeve. Gjithashtu operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK ka dështuar në argumentimin e detajuar të anës ekonomike të metodës së shërbimeve të ofruara, pasi për realizimin e këtyre shërbimeve ndonëse ka përcaktuar llojin dhe sasinë e produkteve të nevojshme për realizimin e shërbimit, duke deklaruar se do të përdorë 20 (njëzet) lloje të ndryshme produktesh të kombinuara me njëra-tjetrën për kryerjen e shërbimeve, por nga ana tjetër ka dështuar që të argumentojë koston e deklaruar të këtyre produkteve, pasi me dokumentacionin provues të dorëzuar dhe konkretisht faturat tatimore të shitjes të sipërpërmendura, ka deklaruar koston e blerjes të vetëm 18 (tetëmbëdhjetë) produkteve. Për më tepër, me faturat tatimore të shitjes me numra: 165, datë 29.08.2022 dhe 161, datë 10.08.2022, ka dështuar që të argumentojë vlerën e shërbimit objekt-prokurimi, pasi në këto fatura nuk është e përcaktuar sasia e sipërfaqes për të cilën është realizuar shërbimi i dezinfektimit objekt i këtyre faturave dhe për më tepër nuk mund të përcaktohet çmimi i shërbimit për 1 (një) metër katror.*

KPP gjykon, se ankimuesi pranë autoritetit kontraktor, konkretisht nuk ka paraqitur dokumentacion te plotë për zbërthimin e anës ekonomike të metodës së ndërtimit, si një nga komponentët e rëndësishëm të nenit 93 të LPP. Referuar argumentimit të ofertës anomalisht të ulët, por edhe në parashtrimet në ankesë, ankimuesi i referohet përmbushjes së gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet. Operatori ekonomik, ka detyrimin të paraqesë të detajuar analizën e kostos së shërbimeve në trajtë analitike, pra të argumentojë me prova dhe fakte si dhe të justifikojë çmimin e ofertuar për çdo shërbim.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se një parashikim i tillë gjen mbështetje edhe në Direktivën 24/2014 KE “Për prokurimin publik”, ku në nenin 69 të saj, parashikohen edhe kushtet për pranimin e ofertës anomalisht të ulët, në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, në nenin 69 të saj parashikohet se: “ Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

Shpjegimet e përmendura në paragrafin 1, jepen veçanërisht për:

- (a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- (b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- (c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- (d) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 18, paragrafi 2;
- (e) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 71;
- (f) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” SHPK është dorëzuar dokumentacion provues mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, por referuar pikës a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; dokumentacioni i dorëzuar nuk analizon koston me çdo shërbim që kjo procedurë përmban, duke mos përmbushur kështu një nga kushtet e rëndësishme kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së. KPP gjykon, se ankimuesi nuk ka paraqitur analizë kostoje të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. KPP gjykon, se shpjegimi narrativ i operatorit ekonomik përmes kthim-përgjigjes më datë 13.02.2023 analizon

Argumentimin e ofertës në mënyrë narrative, lidhur me mënyrë dhe anën ekonomike të metodës së shërbimeve të ofruara, pasi ndonëse ka paraqitur anën ekonomike të metodës së ndërtimit të kostos për secilin nga shërbimet objekt-prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit, por pa argumentuar në mënyrën të detajuar këtë anë ekonomike, pasi nuk ka detajuar numrin e fuqisë punëtore dhe kohëzgjatjen e punës për realizimin e këtyre shërbimeve në mënyrë që të llogaritet kosto e fuqisë punëtore për realizimin e këtyre shërbimeve, nuk ka argumentuar koston për të gjitha produktet e nevojshme për realizimin e këtyre shërbimeve, dhe për më tepër, me faturat tatimore të shitjes me numra: 165, datë 29.08.2022 dhe 161, datë 10.08.2022, ka dështuar që të argumentojë vlerën e shërbimit objekt-prokurimi, pasi në këto fatura nuk është e përcaktuar sasia e sipërfaqes për të cilën është realizuar shërbimi i dezinfektimit objekt i këtyre faturave dhe për më tepër nuk mund të përcaktohet çmimi i shërbimit për 1 (një) metër katror.

Sa më sipër, KPP gjykon se shpjegimi narrativ dhe dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga ankimuesi për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nuk janë prova të mjaftueshme në funksion të argumentimit të: anës ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret nuk krijon bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK për operatorin ekonomik “Alpen Pulito” ShPK qëndron.

III.11. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK mbi kualifikimin e shoqërisë “Alpen Pulito” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Silvio Pastrim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Shërbime marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha janë të përcaktuara, me afat 24 Muaj”, me Nr. REF-48360-11-02-2022, me objekt: “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinsektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”, me fond limit të lotit 3.232.130 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

